



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **90**

Prishtinë, më 15.10.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 8.10.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për komplekset memoriale,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.10.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 8.10.2012 me përmirësimet teknike nga Nijazi Idrizi.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës

Kryetari i Komisionit falënderoi në pjesëmarrjen e ministrit Gashi dhe shtoi se për këtë Projekt ka kërkuar edhe Kryetari i Kuvendit të shqyrtohet sa më shpejt. Duke hapur debatin **Kryetari** sugjeroi që të shqyrtohet mundësia që kjo agjenci të mbetet pranë kryeministritë ndërsa ministri **Gashi** arsyetoi kërkesën por duke shtuar se më mirë do të jetë nëse vendoset si organ i pavarur nën mbikëqyrjen e Kuvendit, ngase janë shumë probleme që arsyetojnë këtë kërkesë (ndërtimet e shumë memorialëve pa vendim të Qeverisë për të cilat duhet të vendoset cilat do të menaxhohen e cilat jo, tubimi i borxheve të cilat dikush duhet ti paguaj etj etj). Ministri njoftoi se buxheti për vitin 2013 është i siguar për këtë agjenci por reagoi **Afërdita Berisha** dhe pyeti për personel apo si, gjithashtu pyeti për lista kush i miraton. Ministri tha se nuk ka personel kjo agjenci, dmth do të formohet tani e tutje. **Liburn Aliu** dhe **Daut Haradinaj** kërkuar sqarime të mëtejme : si do të përzgjidhen projektet, nga kush, kush harton listën, memorialet mos të personalizohen etj, duke kërkuar që në këto procese të ndërliken Akademia dhe institucionet tjera relevante. **Sekretari i MMPH** i japi ca sqarime dhe tha se Kuvendi do të vendos dhe do të caktoj organin mbikëqyrës të Agjencisë. **Salih Morina** nuk kundërshtoi që për momentin ky organ të jetë Kuvendi, por mirë do të ishte që në të ardhmen të caktohet një institucion më akomodues. Në pajtim me zyrtarët e MMPH (ministri dhe sekretari i MMPH) Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Komisioni pajtohet që Agjencia për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës të themelohet si organ i pavarur nën mbikëqyrjen e Kuvendit të Kosovës.
2. Shkresa zyrtare lidhur me këtë vendim të Komisionit i dërgohet MMPH në mënyrë që kjo ministri të dërgoj përmirësimet adekuate në Projektligj duke pasur parasysh këtë vendim të Komisionit.

4. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme **Kryetari** sugjeroi shqyrtimin e çështjeve si vijon :

- Peticionin nga Suhareka të banorëve të fshatit Bukosh, rreth prerjes ilegale të pyjeve, për të cilën çështje ky komision është vazhdimisht duke u angazhuar, në eliminimin e kësaj dukurie negative, ndërsa Nijazi Idrizi përsëriti kërkesën për dorëzim të peticioneve anëtarëve të komisionit, të cilat janë bërë disa,
- Për interpretimin e Ligjit për shitjen e banesave, Komisioni u pajtua që kjo bëhet nga ana e organeve dhe institucioneve relevante dhe kompetente (zyrat ligjore), por jo nga ana e këtij Komisioni,
- Për shkak të implikimeve buxhetore të Projektligjeve të Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna, Komisioni ftoi Komisionin për Buxhet në një takim të përbashkët më 22 tetor,
- Vizita e delegacionit të Komisionit në ERRU (enti i ujërave në Tiranë) u shpjegua në hollësi nga kryetari i komisionit, të cilën mirëpriti komisioni pa ndonjë pyetje shtesë, gjithashtu kryetari paralajmëroi një vizitë tjetër për Shqipëri-Durrës me mbështetje financiare nga OJQ “Ta pastrojmë Kosovën” për datën 16-20 tetor, pas sqarimeve u vendos që vetëm Kryetari shkon në këtë vizitë,
- Në disa pyetje të parashtruara nga anëtarët e komisionit, kryetari u përgjigj (pyetja e Sevdije Lamës rreth sinjalizimeve etj).

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani

